

INTERVISTË ME GORDANA GJORIQIN

Llappllasellë | Data: 14 dhjetor 2019
Kohëzgjatja: 87 minuta

Të pranishëm:

1. Gordana Gjoriq (E intervistuar)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Gordana Gjoriq: Unë jam Gordana Gjoriq. Jam e lindur më 19.09. '59 në Prishtinë, e përndryshe babai im dhe gjyshi, stërgjyshi janë të këtij fshati, nga Llapllasella, ku edhe unë kam jetuar diku deri në moshën tetë, nëntë vjeçare, pastaj jemi shpërngulur në Prishtinë. E pastaj '81-tën, kur jam martuar në vitin '80, pastaj e kemi blerë këtë truall, sepse kam dashur ta ndërtoj shtëpinë në fshatin tim dhe të jetoj në një mjedis të shëndosh dhe normalisht me familjen.

Anita Susuri: Fëmijëria juaj, kujtimet e para.

Gordana Gjoriq: Po them, kujtimet e mia të para, kur është fjala për këtë fshat, me të vërtetë janë të mrekullueshme. Thjesht, së pari, ambient i shëndosh. Së dyti, sistemi i vlerave ka qenë tjetër. Atëherë njerëzit janë dashur më shumë, janë shoqëruar, ashtu edhe ne fëmijët, dhe e ndihmonim njëri-tjetrin. Për shembull, kur ka pasur ndonjë korrje, diçka, a është fjala për punën në fushë apo diçka rreth shtëpisë kështu, fqinjët kanë ndihmuar dhe normalisht ne fëmijët kemi qenë gjithmonë aty me prindërit dhe i kemi ndihmuar njëri-tjetrit. Fëmijët kanë qenë pa halle. Normalisht, askush prej neve nuk ka pasur shumë atëherë, por kemi qenë të kënaqur me, me atë pak çfarë kemi pasur.

Lojërat, të cilat atëherë në përditshmëri, po them kështu, i kemi përfshirë në jetën tonë të përditshme, ato kanë qenë me bimë të ndryshme, me bimë, pastaj disa me gurë apo ku ta di unë, me top normalisht, ajo ka qenë lojë, i bënim topat prej leckave, prej ashtu diçka, prej leshi, sepse askush, rrallë kush prej neve kishte aq para për ta blerë, për atë kohë po flas, topin. Vajzat bënë kukulla, ashtu me dorë i qepnin, i bënë qarqafët, nuk e di, por kemi qenë mund të them gjithë ditën jashtë dhe në një shoqëri të madhe, që normalisht tani është diçka e rrallë.

Anita Susuri: Çfarë kanë qenë prindërit tuaj, familja juaj çfare ka qenë?

Gordana Gjoriq: Po mund të them e madhe (qesh), fillimisht e madhe, por babai im e ka pasur një martesë [më herët]. Në atë martesë (kollitet) i ka pasur dy vajza dhe një djalë, përkatësisht dy vajza dhe dy djem, por ka ndodhur një tragjedi, që djali me 17 vjet është sëmure shumë dhe ka vdekur në spital. Dhe atë ditë kur ju kanë lajmëruar që djali ju ka vdekur edhe gruaja e tij ka vdekur në prag [të shtëpisë] sepse nuk ka mundur ta duroj dhimbjen. Pas një kohe të caktuar, disa vite kanë kaluar, babai

im është martuar me nënën time dhe në atë martesë i ka pasur edhe dy fëmijë, domethënë mua dhe vëllaun.

Por me të vërtetë, kur është harmonia në pyetje ndërmjet neve fëmijëve, kjo kurrë nuk është bërë çështje, por ne kemi qenë shumë, shumë të afërt. Edhe sot e kësaj dite kjo ka mbetur, por fatkeqësisht, dy vëllezër më kanë vdekur dhe motra më e madhe, kemi mbetur vetëm unë dhe motra, e cila tani jeton në Nish, me cilën jam shumë, shumë e afërt, edhe me fëmijët e vëllezërve, djalin, vajzën e motrës, fëmijët e tyre ende jemi aq të afërt.

Personalisht mendoj se kjo është pasuria e vërtetë, sepse, t'ju them diçka, të gjitha vlerat tjera janë kalimtare, por dashuria në familje, bashkësia, kjo është diçka që është më e rëndësishmja dhe që duhet të zgjas, sepse kur e ke më së vështiri prapë është aty i afërmi i yt për të dhënë kurajo dhe ndihmë apo normalisht t'i gëzohet suksesit tënd dhe të përkrah. Dhe unë jam e lumtur për këtë, dhe ndoshta, ndoshta kjo për mua është motiv, po them, drejt përparimit por edhe për tejkalim të shumë problemeve që i kemi pasur gjatë jetës.

Anita Susuri: A keni pasur ndonjë traditë në shtëpi, ndonjë festë, si i keni përgaditur ato?

Gordana Gjoriq: Po, si jo. Ne edhe në atë kohë, por nëse mund të them tregimet janë të ndryshme por në kohën e ish-Jugosllavisë, në kohën e komunizmit ne i kemi festuar festat tona dhe babai im edhe pse ka qenë luftëtarë dhe ka luftuar në kohën e atyre luftërave të mëdha që kanë qenë, ne të gjithë këtu, sidomos në këtë fshat, të gjithë i kemi festuar festat tona. Festa jonë familjare ka qenë Shën Gjergji dhe normalisht që atëherë kemi përgaditur të gjitha në atë kohë, dhe çka kemi pasur mundësi sepse nuk kemi qenë ashtu të pasur, dhe patjetër është përgaditur ajo që atëherë ka qenë e rëndësishme, dhe kemi pasur mysafirë, si fëmijë i gëzoheshim atyre ditëve të festës që zgjasnin nga një ditë dy-tre edhe mysafirëve që na vinin normalisht në atë kohë edhe ato shoqërimet që i kemi pasur në kohën e festave. Domethënë, ajo është, e të mos flasim për Krishtlindje, Pashkët, dua të them janë festuar ashtu siç festohen sot dhe kjo është diçka që është pjesë e traditës sonë të cilën e kemi kultivuar dhe do ta kultivojmë në të ardhmen.

Anita Susuri: Më keni thënë që babai juaj ka luftuar në Luftën e Dytë Botërore, apo jo?

Gordana Gjoriq: Në të dytën, po.

Anita Susuri: A ka pasur ndonjë tregim për këtë, a ka folur ndonjëherë për këtë?

Gordana Gjoriq: Paj, po, por tregimet e tij nuk kanë qenë kështu të them të bukura, ai është munduar të na kursej, të them prej atyre tregimeve të këqija, por gjithmonë tek ne ka ndikuar që të bëhemi njerëz të mirë, ta respektojmë diversitetin e njerëzve të tjerë, që të ketë lënë tek ne çfarë njeriu është, a është njeriu i mirë e jo çfarë ka, si ka, sepse thoshte kjo është e kalimtare. Ashtu si e konsideroj edhe unë personalisht që pasuria materiale është e përkohshme, por pasuria njerëzore që ne duhet ta kemi dhe dashurinë që duhet ta përhapim te njerëzit kjo është diçka më e vlefshme.

Anita Susuri: Si ka qenë kështu në fshat në atë kohën kur keni qenë ju fëmijë? Sepse më keni thënë që keni jetuar këtu.

Gordana Gjoriq: Po, po. Paj t'ju them ky lumë ka qenë i pastër (qesh). Ky, ky me të vërtetë... ka qenë për neve vend ku ne si fëmijë jemi mbledhur. Kur bëhej verë ne lahem në atë lumë. Prindërit tonë, përkatësisht nënat tona dhe gjyshet i kanë larë rrobat në atë lumë, sidomos aty te ura në qendër të fshatit. Ka qenë edhe një mulli andej kur shkoni kah Graçanica, nga ana e majtë, edhe aty njejtë, unë shpesh shkoja me nënën, t'i ndihmoj t'i laj rrobat, lahem aty në lumë. E dimrit, lumi ngrihej, pastaj aty ka qenë vendi për skijim, pastaj luanim me disa shkopinj i shkurtonim shkopinj të drurit dhe i rendisnim aty në akull. E kemi pasur një shënjuar të cilin e quanim ashtu dhe pastaj luanim gjatë gjithë ditës aty. Ka pasur mjaft gjelbrim, mund të them, shtëpia ime është aty përball Shtëpisë së Kulturës, në qendër të fshatit dhe pastaj aty mbledheshin të gjithë, por gjithashtu më ka mbetur në mendje, për shembull, që dimrat kanë qenë përplot me borë.

Për shembull, prej tetorit, fillim i nëntorit, kur binte bora, bora nuk shkrihej diku deri në shkurt, në fund të shkurtit, në fillim të marsit. Ka ndodhur, për shembull. Ndodhte që rreshjet ishin aq të mëdha, sa që më kujtohet se babai më barte në shpinë (qesh) për në shkollë. Domethënë, shkolla ka qenë, të paktën sa më kujtohet, kjo shkolla e re që është ndërtuar ku ndodhet edhe tani, e shtëpia është domethënë, ja të them diku 200 metra, 300 larg prej asaj shkollës, por babai është dashur të më dërgoj në shkollë. Ja t'ju tregoj kështu, ne kurrë nuk kemi pasur bagëti, lopë apo atë-këtë, por unë shkoja me shoqet e mia për t'ju ndihmuar, shkonim bashkë t'i ruanim lopët, ku e di t'ju ndihmonim për ta mbledhur prodhimin apo kështu, dhe për mua kjo gjithmonë ka qenë interesante, sepse për mua ka qenë e rëndësishme të jemi të gjithë bashkë.

Anita Susuri: Kur keni filluar të shkoni në shkollë, cilat janë kujtimet tuaja prej shkollës?

Gordana Gjoriq: Po kujtimet (qesh) janë të tilla që, unë kam qenë fëmijë mistrec, mund të them për veten, dhe disi gjithmonë jam ndarë sepse kam pasur të caktuara (kollitet), qëndrime të caktuara si duhet, a e di, të sillesh, për shembull, me mësuesin dhe kështu. Dhe kam qenë njëfarë, njëfarë, kam pasur nevojë dikë ta mbroj, të jem unë ajo që do t'i arsyetoj, për shembull ndonjë nxënës apo kështu dikë, prandaj mësuesja (qesh) gjithmonë më quante "avokate", sepse nëse ajo e kritikonte ndonjë nxënës, unë thosha, "Po mësuese ju nuk keni të drejtë. Ai kështu, kështu..." "Hajde ulu ti avokate". Domethënë, ky është njëfarë, njëfarë kujtimi im, kur është çështja te mësuesit me të vërtetë kanë qenë të drejtë, por edhe shumë të rreptë. Por edhe sot e kësaj dite mendoj që kanë pasur të drejtë dhe ne në shkollë kemi marrur edukim të caktuar që është dashur të respektohet, por edhe prindërit mos dashtë Zoti nëse gabonim diçka në shkollë, ne nuk guxonim t'ju tregonim prindërve sepse pastaj ata dyfish na kanë (qesh) dënuar.

Dhe kështu. Prandaj me të vërtetë të gjithë, mund të them kemi arritur suksese të mëdha, a është në pyetje ajo dituria, por e kemi pasur edhe kulturën dhe edukimin e mirë, dhe prapë po them në shkollë së pari na kanë mësuar t'i duam njerëzit. A e dini si thonë, në fakt nuk thonë por ashtu është sigurt edhe tek ju, sepse kur flisnim me miqtë e mi në atë kohë, me shqiptarët, turqit dhe kështu, të gjithë i kanë pasur mendimet e njejta. Thoshin, "Zoti i ka krijuar njerëzit për t'u dashur, e gjërat për tu

shfrytëzuar”. Fatkeqësisht tani sistemi është ndryshuar dhe tani njerëzit më shumë i dojnë gjërat, e njerëzit i shfrytëzojnë për ti fituar ato gjëra. E kjo është tragjedi. E atëherë kemi pasur edukim të tillë dhe kemi qenë të lumtur të gjithë.

Anita Susuri: A ju kujtohet ku keni udhëtuar për herë të parë, për shembull jashtë, jashtë fshatit tuaj në Prishtinë apo ku ta di unë?

Gordana Gjoriq: Edhe kjo ka qenë qesharake, t’ju tregoj, sepse këtu të gjithë kemi qenë të mësuar që duhet t’i përshëndesim më të moshuarit dhe tani në fshat kur dilnim në rrugë dhe kalonte ndonjë njeri i moshuar, normalisht, i përshëndesim, “Mirëdita!” dhe kjo ka qenë bazike. Dhe, dhe (qesh) kur më ka sjellë në Prishtinë, dhe tani përnjëherë (qesh), kam parë shumë njerëz, unë kthehesha ashtu e habitur, nuk dija çfarë të bëj, ju thosha, “Mirëdita!” Dhe nëna normalisht ma ka tërhequr vëmendjen që kjo nuk vlen për Prishtinën sepse (qesh) ka shumë njerëz.

Domethënë, ato janë, kurrë nuk do t’i harroj ato kujtimet, kam qenë me të vërtetë shumë, shumë e vogël, por pas kësaj normalisht ne kemi kaluar të jetojmë atje dhe unë ndryshe, ndryshe i shikoja ato gjëra. E kam udhëtuar, për shembull kam kujtime edhe kur kam udhëtuar për herë të parë me tren për në Beograd dhe treni është nisur prej Fushë Kosovës. Kjo për mua ka qenë me të vërtetë përjetim mbi të gjitha, sepse aty mund të shëtitesh, të shkosh, nëpër kabina, të bisedosh me njerëzit, pastaj fëmijë të tjerë, luanim aty, thjesht ka qenë përjetim i vërtetë për mua kur është fjala për atë udhëtim. E normalisht më vonë (qesh) kanë qenë komplet më ndryshe, këto përjetimet.

Anita Susuri: E shkollën pastaj, a keni ardhur pastaj në Prishtinë për...

Gordana Gjoriq: Po në klasën e tretë...

Anita Susuri: Të tretën, aha.

Gordana Gjoriq: Të tretën dhe të katërtën pastaj e kam përfunduar në Prishtinë, shkollën dhe më tutje jam shkolluar...

Anita Susuri: A ka ardhur pastaj familja juaj të jetoj në Prishtinë apo si ka qenë?

Gordana Gjoriq: Jo. Jo, jo kanë mbetur këtu. Nëna ka punuar në Prishtinë, pastaj unë e kam pasur banesën atje, kur është dashur të shkollohem aty, kam qenë afër saj.

Anita Susuri: Kur jeni rritur si vajzë, si ka qenë Prishtina atëherë për juve? A keni dalur dhe si ka qenë, a mund të na përshkruani?

Gordana Gjoriq: Po mirë, t’ju them diçka, Prishtina për të gjithë ne ka qenë vend ku dashuritë e para i kemi përjetuar, e ndoshta keni pasur rast kur ju ka treguar dikush, e kemi pasur korzon, ku secili e ka pasur vendin e vet, ku jemi mbledhur si shoqëri, te druri, apo para “Krashit”, apo para “Avallës” përpara aty, kinemasë “Vllaznimi” dhe kështu. Dhe normalisht aty ka pasur ngacmime nga ana e

djemve, por ka pasur edhe ashtu të them, ngjarje të palakmueshme që ne vajzat i kemi përjetuar, sidomos nëse jemi treguar pak arrogante, e secila prej neve ka qenë, në në situatë të, sepse ka qenë edukimi i tillë që ty nëse dikush të pëlqen të mos e pranosh menjëherë atë, por duhet pak të presësh, duhet pak ta refuzosh, siç thoshin (buzëqesh).

E tek të shumtë ka shkaktuar pak, te shumë meshkuj, djem, ka shkaktuar pak zemërim, e nganjëherë edhe dinin të ofendonin me disa komente dhe kështu, dhe sidomos nëse i ke refuzuar, e nuk ke dashur të bisedosh me ta apo ta njohësh atëherë kanë qenë pak më të ashpër. Por për mua ka qenë interesante, sepse prapë po them e kemi pasur shoqërinë tonë edhe me meshkuj kam pasur shumë shoqëri, shokët e mi meshkuj me të cilët shoqëroheshim së bashku, dhe kemi ditur me të vërtetë t'i organizojmë ato mbrëmje, të jetë interesante, e bukur dhe kështu.

Pastaj në atë kohë për shembull, nuk ka pasur shumë vende të tilla për dalje, por ne kemi organizuar ndeja. Për shembull, festonim ditëlindje edhe kur nuk e kishim ditëlindjen. Ja ky ka qenë një arsyetim le të themi, "Ej", kinse, "ditëlindjen e kam, ajde të bëjmë ndejë!" Pastaj mblidheshim të gjithë në ndonjë banesë, secili prej nesh përgadiste diçka për të ngrënë, apo prindërit na përgadisnin, nëna për shembull, përgadiste diçka prej mezeve pastaj aty lëshonim muzikë, ato që kanë qenë *long play*, pllaka, dhe kështu shoqëroheshim atë mbrëmje, dhe normalisht, ka qenë argëtuese për ne.

Anita Susuri: Çfarë muzikë keni lëshuar? Çfarë muzike dëgjohej atëherë?

Gordana Gjoriq: Po mirë, unë kam, unë kam qenë rokere (qesh), mund të them prej, prej që di për veten. Për shembull, Tom Jones e kam adhuruar, Rolling Stonsat në atë kohë, dhe kështu prej këtyre të huajve. Tonët normalisht, Zdravko Çolliq, Gjorgje Marjanoviqi ka qenë atëherë, pastaj Zdravko Çolliq, dhe të gjithë ata këngëtarët të cilët, "Bijello Dugme", "Riblja Çorba" dhe të gjithë këngëtarët që kanë qenë atëherë, apo grupet që kanë qenë atëherë, dhe normalisht për neve kanë qenë... Zdravko Çolliq ka qenë më, më i popullarizuar tek ne gratë (qeshet), vajzat atëherë, dhe atëherë atë e kemi adhuruar, ato këngët "Gori vatra" dhe të gjitha të tjerat.

Anita Susuri: Çfarë aktivitete tjera kulturore keni pasur atëherë, a keni shkuar në kinema apo në...?

Gordana Gjoriq: Po ka qenë, vetëm ato kanë qenë, kinemaja dhe teatri. Mirë, më shumë ka qenë kinemaja, më e disponueshme për neve, por më duhet të them që unë edhe, edhe atëherë nëpërmjet të disa aktiviteteve, për shembull, unë përmes shkollës kam qenë e kyçur në klube, ky Kryqi i Kuq, pastaj shkonim kur kishte ndonjë aksion, shkonim mblidhnim para të caktuara në disa kuti që i kemi pasur prej Kryqit të Kuq pastaj kështu shkonim nëpër qytet dhe mblidhnim për grupe të caktuara njerëzish për shembull, fëmijët apo për atë-këtë, në UNHCR apo kështu.

Gjithashtu kam qenë e kyçur në Klubin e Kombeve të Bashkuara i cili ka qenë dikur në Prishtinë atje, ku tani është një pjesë e televizionit. E dini ajo qendra tregtare te tregu, ajo ka qenë e tipit të mbyllur dhe aty, aty ka qenë edhe biblioteka jonë, një bibliotekë, sepse ajo e qytetit ka qenë këndeje dhe aty bashkoheshim ne fëmijët në atë klubin. Shumë aktivitete i kemi bërë e kemi pasur edhe hotelin tonë në Gërmi, atje shkonim për të bërë kamping, dhe dua të them, ka qenë me të vërtetë interesante.

Pastaj kam qenë e kyçur në shoqëri folklorike, për shembull në Fushë Kosovë, “Branko Medenica”, dhe përmes asaj shoqërisë folklorike e kemi tejkaluar gjithë Jugosllavinë atëherë dhe jemi shoqëruar, sidomos në atë shoqërinë folklorike. Aty e kemi kultivuar folklorin, lojërat folklorike të të gjitha kombësive që në atë kohë kanë qenë tek ne, për shembull unë kam qenë soliste e shotës dhe çoçekit, ato lojërat turke. Normalisht edhe këto tonat serbe, çaçakin, moravcin, të Moravës, lojërat e Vranjes apo ato-këto.

Po ju them atëherë kemi marrur pjesë nëpër festivalet e të gjitha shoqërive folklorike, hekurudhore, sepse ne kemi qenë shoqëri folklorike hekurudhore e cila është organizuar në Lublanë në sallën Tivoli, dhe ne e kemi fituar vendin e parë me lojën tonë shota, ku unë dhe një koleg i imi Zhiviqi, kemi qenë solistë dhe e kemi fituar çmimin, tani nuk e di çfarë sasive ka qenë, por me ato para kemi mundur ta blejmë veshjen origjinale për të gjitha vallet, që ka qenë për neve me të vërtetë sukses i madh dhe diçka e bukur...

Anita Susuri: Në cilin vit e keni fituar atë çmim?

Gordana Gjorij: Po tani nuk më kujtohet në cilin vit, por unë i kam pasur atëherë diku 16 vjet, 15-16 vjet, e ju shihni se kur ka qenë (qesh) kohë më parë, kohë më parë. Kështu që, këto janë disa kujtime të bukura për ne. Për mua.

Anita Susuri: Në cilën shkollë të mesme keni shkuar?

Gordana Gjorij: Kam shkuar në shkollën ekonomike.

Anita Susuri: Ku ka qenë kjo, në Prishtinë?

Gordana Gjorij: Në Prishtinë atje tek, si quhet ajo, Fabrika e Kosovës, tjerrtorja, aty.

Anita Susuri: Si keni marrur vendim të shkoni në atë shkollë të mesme?

Gordana Gjorij: Paj, t’ju them diçka, thjesht, kam menduar se prapë, unë jam, mua edhe më pëlqen kontabiliteti. Dhe pas kësaj ja mund të them, edhe pse e kam përfunduar Shkollën e Lartë Ekonomike, drejtimin për kontabilitet dhe kurrë nuk kam punuar në arsim. Por, për shembull të gjitha ato që i kam mësuar për kontabilitet më ka ndihmuar kur kam filluar të punoj në shpedicionin “Transjug Rijeka” sepse aty, e kam drejtuar administratën. Dhe normalisht më së shumti më ka ndihmuar kur e kam hapur ndërmarrjen time private në vitin ‘90 kur u vendos ligji që mund t’i regjistrojmë kompanitë private. Pastaj kjo më ka ndihmuar që të mund të kontrolloj, ndjekë, planifikoj financat në kompaninë time. Prandaj edhe e kam zgjedhur këtë atëherë, sepse për mua nuk është e vështirë të mbes gjithë natën të, që thonë kontabilisti kërkon gabimin, nëse sheh dritë diku në ndonjë ndërmarrje. Kështu që, kjo ka qenë arsyeja pse e kam zgjedhur atë shkollën.

Anita Susuri: Pra, puna juaj e parë ka qenë fillimisht në atë ndërmarrje?

Gordana Gjoriq: Në shpedicion, po, punësimin e parë e kam pasur aty, ajo është “Transjug Rijeka”, shpedicion ndërkombëtarë i cili gjendej në Lakrishte. Drejtor e kemi pasur Munibca Hasi, të cilin shumë e respektoj dhe mund të them që me të vërtetë shumë, shumë kam mësuar. Ai ka qenë për të gjithë ne, ka qenë mjaft i rreptë, por e gjithë kjo me qëllim që sa më mirë të mësojmë dhe të kemi rezultate sa më të mira. Dhe po them, atë dije që e kam marrur atje, e kam filluar të punoj si një manipulante e thjeshtë administrative nëse mund të them kështu, që unë them *potrčko*¹.

Me atë punë kam filluar, pastaj kam arritur në situatë që të marr çmime prej OPSH²- ve nga Shibeniku, nga Rijeka, sepse ajo ka qenë njëra prej kompanive më të mira në, në ish-Jugosllavi, e cila i ka pasur OPSH-të e veta nëpër të gjitha kryeqytetet e republikave që kanë qenë atëherë. Dhe me të vërtetë ka qenë për mua nder i madh kur fitoja ndonjë çmim si punëtores e suksesshme, punëtores e mirë, dhe kështu.

Anita Susuri: Si kanë qenë kushtet e punës në atë kompani, në atë kohë?

Gordana Gjoriq: Paj mund të them, që kushtet kanë qenë fenomenale në çdo kuptim që mund të them, sepse në atë kohë ka mbizotëruar sistemi, dhe kjo ka qenë shumë e rëndësishme për të gjithë ne. Dhe për shembull, si fillestare ti ke pasur mundësi të më mësosh të gjitha që janë të rëndësishme për të qenë i suksesshëm në profesionin tënd nëse mund të them kështu. E dyta për shembull, në ndërmarrjen tonë çdo dije është nivelizuar në katër nivele dhe ti tani fillon nga i katërti dhe arrin deri te i pari, nëse je i aftë, normalisht, e nuk mbetesh referent i ri përgjithmonë. Vetëm nëse nuk je i aftë apo nuk dëshiron të të përparosh.

Domethënë, është dhënë mundësia t’i mësosh të gjitha që janë të nevojshme. Na është mundësuar normalisht të shkojmë të edukohemi, t’i, t’i vizitojmë seminarët e ndryshme që të jemi më të suksesshëm dhe ka qenë shumë e rëndësishme që në atë kohë nuk ka pasur as korrupsion, këtë mund ta konfirmoj, sigurisht. Por, përkundrazi sistemi i vlerave ka qenë i tillë që është dashur ta respektosh, ke pasur ligje që janë respektuar dhe ti ke mundur ta planifikosh gjashtë vite më herët punën tënde, dhe sipas atij plani organizohesh, gjë që ka qenë shumë e rëndësishme.

Normalisht, të ardhurat kanë qenë adekuate në bazë të asaj se sa ke kontribuar ti si individ për ndërmarrjen tënde, dhe sa ke treguar mjeshtri dhe çfarë rezultate ke arritur. Dhe kjo ka qenë mjaft e rëndësishme, domethënë, ti ke qenë i stimuluar të mundohesh, të punosh sepse e dije që do të, do të shpërblehesh për atë, dhe normalisht mëson, edukohesh që të kesh më shumë sukses. Për fat të keq, sot kjo rrallë që ekziston.

Anita Susuri: Si kanë qenë marrëdhëniet me kolegë? A keni pasur shqiptarë aty?

¹ Zhargon popullor - fillestar prej të cilit të gjithë kërkojnë ta kryej një obligim.

² Organizata e Punës Shoqërore.

Gordana Gjorij: Po, si jo! Thashë në atë kohë, si privatisht ashtu edhe në punë, të gjithë kemi punuar bashkë dhe askush nuk ka shikuar kush është çfarë kombësie. Për shembull, drejtori ishte shqiptar, Munibca Hasi nga Gjakova, por aty i kam pasur kolegët, edhe shqiptarë të tjerë, ka pasur turq, kanë qenë dy kolege serbe i kam pasur, domethënë, dhe kemi qenë si familje. Dhe po them ja, vetëm një rast kur, po mendoj një situatë, ne çdo vit kemi organizuar ditët e “Transjugut”. Dhe kjo ka qenë mundësia që të gjithë partnerët t’i mirëpresim, t’i nderojmë dhe të shoqërohemi të gjithë së bashku dhe këtë e kemi organizuar në “Hotelin Grand” në atë kohë. Por nuk kemi pasur mjaft para që t’i ftojmë 200, 300 njerëz dhe këto t’i paguaj kompania. Po mendoj, kjo nuk ka qenë e zakonshme atëherë, sepse kjo ngjarje ka qenë më e vogël sepse është dashur të jetë brenda kostove të tjera.

Por, pastaj ne së bashku, shtatë prej neve sa kemi punuar aty, bashkë i kemi blerë ushqimet dhe bashkë i kemi përgaditur, a e dini ato që janë, që tavolinat t’i kishim më të pasura, që të gjithë ata partnerët tonë, partnerët e punës që na vijnë dhe mysafirtë që vijnë nga anët tjera, mund të mburrem që mysafirtë vinin nga të gjitha qytetet, prej OPSH-ve nga e gjithë Jugosllavia, e plus kemi pasur mysafirë madje edhe politikanë e deri te drejtori i doganës, shtëpi të eksportit nga Prishtina dhe kështu të gjithë të tjerët. Dhe mund të them 80 përqind të ushqimit dhe pijeve ne vet i kemi përgaditur dhe i kemi blerë.

Dhe ky ka qenë rasti të shoqërohemi me ta dhe t’ju falënderohemi për atë që kemi punuar bashkë. Mund të them gjatë gjithë vitit, nuk ka qenë sikur tani, “Hajde në kafene, shkojmë në restaurant, shkojmë të...” Jo, jo, kjo ka qenë një herë në vit kemi përgaditur, por pikërisht për këtë që të gjithë kemi qenë të unifikuar dhe kemi kaluar mirë si kolegë, ne i përgadisnim së bashku ato. A ka qenë këtu në shtëpinë time e cila tashmë, këtu e kam bërë shtëpinë dhe në dhomën e ndejës këtu, apo ka qenë tek kolegët, dikush tjetër diçka ka përgaditur vet, por kjo ka qenë shumë e rëndësishme.

Gjithashtu e rëndësishme ka qenë që i kemi ndihmuar njëri-tjetrit kështu. Nëse duhej e kishim kasafortën e përbashkët, për shembull, që tani besoj se ju apo cilido prej të rinjve nuk i mbledh, dhe tani ndonjërit prej kolegëve ju nevojitet, i është sëmurë fëmija, ku ta di unë, ai është sëmurë, apo ku ta di, i është djegur [shtëpia], apo ka pasur ndonjë prishje diku në veturë apo ajo-kjo, dhe tani nuk mund ta mbuloj paga e tij, pastaj prej asaj kasafortës së borxhit i jepet atij. Apo për shembull, ne kështu mbledhemi të gjithë, shkojmë në shtëpi, ndihmojmë për të gjitha që nevojiten.

Dua të them, jam shumë e lumtur dhe me të vërtetë i kam kujtimet e mrekullueshme, dhe jam falënderuese që kam kujtime të bukura për atë periudhë. Si kam punuar dhe se si menxi kam pritur të shkoj në punë. Domethënë, unë i jam gëzuar çdo dite të punës. Kur vinte fundjava atëherë ke mjaft obligime si grua, normalisht, edhe si nënë, dhe prapë e kemi pasur rrethin e gjërë të miqve, dhe kemi jetuar këtu, në këtë shtëpi, dhe pastaj vinin miqtë me fëmijë, vikendin e kalonim këtu, shoqëroheshim, meshkujt luanin letra, ne gratë përgadisnim ushqim, fëmijët luanin, por kanë qenë të gjitha kombësitë.

Nuk ka qenë fare që vetëm serbët apo janë mbledhur vetëm shqiptarët, por ne i kemi pasur kumbarët shqiptarë, sllovenët gjithashtu i kemi pasur miq, kroatët të gjithë që kanë jetuar këtu, por edhe ata që i kanë pasur interesimet e njejta sikur ne. Qoftë kanë pasur dëshirë të merren me sport apo shkonin në skijim. Për shembull, mua më ka mësuar të skijoj në Brezovicë, Besim Shala, i cili ishte, mund të them,

miku im më i mirë në atë kohë, edhe tani është poashtu, por fatkeqësisht nuk jeton më këtu, jeton në Kanadë. E ai ka punuar në “Jat” [agjension turistike] te “Grand Hoteli”, prandaj ka qenë skijator shumë i zoti, poashtu edhe Fatmir Hapçiu i cili ka punuar në “Kosovo Drvo” edhe ai ka qenë poashtu skijator i zoti dhe pastaj mbledheshim dhe shkonim më herët.

Për shembull, para “Grand Hotelit” shkonte autobusi në mëngjes. Shkonim në Brezovicë lartë, atëherë ka qenë ky “Narcis” dhe “Stojkova kuća”, këto hotelet dhe sapo ndërtohej ky tjetri, por ka qenë ai teleferiku i vogël. Pastaj shkonim në mëngjes dhe skijonim gjithë ditën, në ora pesë kthehemi kënde. Poashtu, të gjithë ata miqtë, për shembull, kujtimet e mia janë këtë nuk e përmenda, ish-bashkëshorti im është marrur me peshkatari, dhe vjehri im dhe... Atëherë kur jam martuar unë edhe mua më ka hyrë në qejf peshkataria. Dhe mund t’ju them i vetmi çmim që atëherë e ka fituar ekipi nga Prishtina, Kosova, ka qenë çmimi që unë e kam fituar. Kanë qenë në garat jug... në garat jugosllave...

[Video ndërpritet]

Gordana Gjoriq: A bën?

Anita Susuri: Po më flisnit për kolegët...

Gordana Gjoriq: Po, po edhe kolegët, por tani u ndërlidha edhe me miqtë kështu. Po them, përveç skijimit ne jemi shoqëruar edhe në peshkim. Thashë që i vetmi çmim në atë kohë, Kosova që e ka fituar vendin e parë në Jugosllavi për peshkim ka qenë çmimi që e kam fituar unë dhe ekipi im. Dhe gara u mbajt në liqenin e Batllavës, garat federale. Normalisht e kam pasur përkrahjen e komplet ekipit, shoqatës tonë e cila është quajtur “Bozhur”. Kështu, xhaxhi Muja ka qenë kryetar i asaj shoqatës dhe të gjithë meshkujt që atëherë janë diskualifikuar nga gara më kanë dhënë përkrahje, dhe më kanë inkurajuar atë ditë kur e kam kapur numrin më të madh të peshqëve dhe e kam fituar çmimin e parë në Jugosllavi për peshkim (qesh).

Domethënë, kjo ka qenë diçka që me të vërtetë ja ka vlejtur për mua, por po them, peshkatarë kanë qenë edhe shqiptarët edhe serbët dhe ne të gjithë së bashku jemi përgaditur. Për shembull, për vikend kur është koha e mirë shkonim në liqenin e Batllavës apo në Drin, apo në Sitnicë, apo ndonjë lumë tjetër këtu. Pastaj secili prej neve merrte ushqim me vete, po them kështu nga shtëpia. Nëse shkonim në Drin atëherë në Prizren ktheheshim në ora tre të mëngjesit, blenim bukë dhe pastaj shkonim dhe peshkonim gjithë ditën. Atëherë aty ka pasur përjetime të ndryshme dhe kështu.

Nëse e keni festuar ditëlindjen e fëmijëve, ajo është normale të gjithë shkonim te njëri-tjetri, në përgjithësi për festa, Bajram, tamam puna, menxi prisja kur po vjen Bajrami, sepse unë e adhuroj atë bakllavën e shtëpisë të cilën e përgadisnin mikeshat e mia apo vjehrrat dhe nënat e tyre, dhe atëherë normalisht për Bajram, ajo është patjetër. Përveç kësaj, kur shkonim atje për urim, dhe fitonim (qesh) gjithmonë edhe një pjatë për në shtëpi. Kështu që kujtimet i kam më të vërtetë të mrekullueshme dhe më mungon shumë ajo jetë.

Më mungojnë edhe ata njerëz që nuk janë më aty në qytet, e disa edhe kanë vdekur. Shumica e tyre janë diku jashtë dhe kanë mbetur jashtë, por fatmirësisht kjo teknologjia është e mirë, dhe ja përmes viberit, internetit, ne dëgjohemi dhe shihemi dhe ja kështu. Nganjëherë qeshim me të madhe, por nganjëherë edhe qajmë kur i evokojmë ato kujtimet. Por më vjen keq që kjo rinia nuk do të ketë kaq tregime të bukura.

Anita Susuri: Kur e keni përfunduar shkollën e mesme, a keni vazhduar pastaj më tutje për studime apo si?

Gordana Gjoriq: Jo, unë jam martuar, kam lindur fëmijë, por jam regjistruar me korrespondencë këtu në Shkollën e Lartë Ekonomike. E përfundova kontabilitetin, dy vite ka zgjatur atëherë, e përfundova kontabilitetin. Kurrë nuk kam punuar në arsim, po them, sepse pas “Transjugut”, kur erdhi ligji, pastaj bashkë me ish-bashkëshortin tim... jemi marrur vesh ta hapim kompaninë tonë private dhe ja. Unë e menaxhoja atë kompaninë private, e cila ka qenë njëra prej më të suksesshmeve në atë kohë në Kosovë, e cila i ka pasur të punësuar rreth 75 punëtorë, ku me të vërtetë, i kemi pasur partnerët e biznesit prapë me të gjitha kombësitë dhe kemi bashkëpunuar me shumë kompani të cilat janë edhe tani të suksesshme këtu. Dhe është bukur për shembull, ja vetëm një ngjarje do ta... çfarë më ka ndodhur para disa vitesh.

Ka ardhur një njeri këtu me një mik timin nga Prishtina dhe po e shoh që po më duket i njofshëm por nuk po më kujtohet kush është, shqiptar. Dhe ai më thotë, “Gordana?” Unë i them, “Po”. “Eh”, tha, “unë jam ky e ky, kjo e kjo kompani. Kur më ka thënë miku im...” të mos përmend emra, “që është me ty në kontakt dhe që po vjen te ti dhe që je këtu në Llapllasellë, unë e luta të vij me të. Dhe erdha vetëm të them që kurrë nuk do të harroj çfarë ke bërë për mua”. Kompania ime atëherë i ka ndihmuar kompanisë së tij. Më besoni që nuk kam ide se për çka është fjala. Sepse me të vërtetë në atë kohë, nuk është shikuar interesi a personal, por është dashur t’i ndihmojmë njëri-tjetrit në mënyrë që të gjithë së bashku të jemi të suksesshëm dhe për të mundësuar që sa më shumë punëtorë të punësohen dhe t’i kenë rrogat më të mira dhe kështu. Dhe të mbijetojmë sepse ka qenë atëherë kur është prishur Jugosllavia ka qenë shumë e vështirë të punosh atëherë dhe të shumtë kanë mbetur pa punë dhe kështu.

Dhe pastaj ka ekzistuar besimi mes nesh dhe të them nëse unë nuk kam bërë diçka të tillë dikush tjetër e ka bërë, e unë kam pasur mundësi t’i ndërli di me ndonjë kompani që është kështu, apo të garantoj për, për atë kompani, unë me të vërtetë këtë e kam bërë me qejf, sikurse shumica më kanë ndihmuar mua. Sepse besimi ka qenë shumë i rëndësishëm atëherë që, që, që, që të mund të punonit, e të mos them të punoni me sukses, dhe ka qenë atëherë, kontrolli vlerës së një kompanie apo i njeriut që e udhëheq atë kompani. Dhe kështu në situatë të tillë, domethënë ka qenë shumë e rëndësishme me kë po bëni biznes dhe kush do të garantoj për juve, apo për mua dhe kompaninë time, sikur unë që kam mundur të garantoj për shumë kompani atëherë që kanë qenë të suksesshme, e që janë edhe tani të suksesshme në Prishtinë.

Por më ka ardhur shumë mirë kur e kam përjetuar atë, të mos them edhe gjëra tjera dhe situata të tjera pozitive, të them, që i kam pasur kur i takoja punëtorët e mi të mëparshëm. Shqiptarët, që me gjithë

zemër kanë dashur të më ndihmojnë dhe që kanë treguar një respekt të madh për të gjitha ato që unë ju kam ofruar atëherë atyre, edhe personalisht kështu por edhe për familjet e tyre, që mendoj se është më e vefshmjë për një njeri.

Anita Susuri: Kur keni filluar të jetoni, ashtu të banoni atje?

Gordana Gjoriq: Po, kjo ka qenë prej klasës së tretë të shkollës fillore.

Anita Susuri: Me familjen tuaj apo si keni filluar?

Gordana Gjoriq: Po ju thash me nënën kam qenë atje, me nënën.

Anita Susuri: Me nënën?

Gordana Gjoriq: Po, me nënën.

Anita Susuri: A mundeni pak më shumë rreth kësaj, ku keni jetuar, çfarë lagje ka qenë?

Gordana Gjoriq: Po mirë, kjo është, t'ju them diçka, kur jetoni privatisht, atëherë shkoni, të them, prej një rrugës në tjetrën apo prej një shkolle në tjetrën. Kemi banuar në shumë vende. Për shembull, unë kam shkuar edhe në shkollën "Vuk Karagjiq", por kam shkuar edhe në "Meto Bajraktari", por kam shkuar edhe në "Branisllav Nushiq" atje te, në fund të Prishtinës kah Gërmia kur shkohet nga ana e djathtë ku është Tauk Bahçja siç e quanim dikur, sepse tani shumë gjëra kanë ndryshuar edhe emërtimet kanë ndryshuar, e nuk e di ju gjeneratat e reja si...

Anita Susuri: Ashtu quhet edhe tani (qesh).

Gordana Gjoriq: Kështu që të them, sa ka qenë ajo negative, por ka qenë në disa raste pozitive sepse kam bërë shumë miq ashtu. Kur keni rast t'i ndërtoni disa paralele, atëherë, atëherë keni edhe numër më të madh të miqve. E normalisht, negative ka qenë sepse tamam njoftoheni, përshtateni me dikë, ndonjë shkolle të re, atëherë duhet prapë të shpërnguleni sepse koha e tillë ka qenë, a e dini, siç thash, ne, familja ime ka qenë mjaft e varfër. Po mendoj, nuk i kemi pasur kushtet e favorshme. Pastaj, fëmijëria nuk ka qenë aq e mrekullueshme, kujtimet të them prej atyre lojërave kështu, por mjaft kam hequr si fëmijë. Dhe ka pasur mjaft gjëra negative në fëmijërinë time kështu që të të them sinqerisht nuk kam dëshirë t'i kujtoj aq ato, ato ditë. Por ndoshta pikërisht për mënyrën e tillë të jetës, kam qenë në situatë që shumë gjëra fëmijëve të mi, nipërve të mi t'ju ofroj, sepse kam konsideruar t'ju jepi sa më shumë dashuri, vëmendje, sepse kjo më ka munguar si fëmijë. Dhe pastaj kam dashur që kjo të mos i mungoj fëmijëve të mi dhe nipërve, gjë që tregon se jemi të gjithë të afërt me njëri tjetrin.

Anita Susuri: Sa fëmijë i keni ju dhe me çka merren ata?

Gordana Gjoriq: Po unë i kam dy djem dhe vajzën. Ata e kanë kompaninë private. Është një furrë, ëmbëltore, dhe ja si të them prodhojnë brumëra, shesin nëpër shkolla, e kanë atë kafenenë,

ëmbëltores, prodhojnë, bëjnë ëmbëlsira, torte, sipas porosisë dhe kështu. Po mendoj, bashkë janë të gjithë. I kam katër nipa, tani për tani. Do të vij edhe i pesti sepse vajzën e kam shtatzënë (qesh). Kështu që, të them se jam e plotësuar edhe si gjyshe, edhe si nënë, kështu që kjo që thash, më e rëndësishmja është që fëmijët i kam shumë të afërt dhe kanë mirëkuptim, i ndihmojnë njëri-tjetrit, edhe pse të tretë janë të ndryshëm me të vërtetë dhe kështu. Por, i pranojnë ato dallimet dhe e kanë mbajtur atë dashurinë ndërmjet vete dhe i ndihmojnë njëri-tjetrit sado që munden dhe më e rëndësishmja është se kanë mirëkuptim.

Anita Susuri: Ju pastaj edhe me familjen tuaj keni jetuar në Prishtinë, apo jo? Me fëmijët tuaj dhe...

Gordana Gjoriq: Po, po, po, po kemi jetuar, afërsisht njëzet vite në Dardani, në lagje, menjëherë afër, në fillim të Kurrizit. Por e kemi pasur banesën, pas kësaj e kemi blerë banesën pas Odës Ekonomike në rrugën Trajko Dimitrijeviq, ish Hajdar Dushi. Aty kemi qenë në katin e dytë dhe kështu.

Anita Susuri: Si keni jetuar aty? A keni pasur fqinjësi apo...

Gordana Gjoriq: Po, si jo. T'ju them diçka, Prishtina është qytet i vogël i mrekullueshëm. Për shembull, në Dardani i kam kaluar njëzet e diçka vite me fqinjët, aty ka jetuar edhe ish drejtori im, ky prej "Transjugut", ai ka jetuar në katin e tretë, unë në të gjashtin. Me të gjithë fqinjët kemi pasur marrëdhënie fenomenale dhe i kemi ndihmuar njëri-tjetrit. Shkonim për kafe, në ndeja, të them ashtu, në ditë festash dhe kështu. Dhe normalisht nëse është dashur të ndihmojmë aty kemi qenë për njëri-tjetrin.

Normalisht, ka qenë aty dikush që nuk është përshtatur, por kështu ka qenë në të gjitha mjediset. Por, 90 përqind e njerëzve kanë qenë pozitiv, në, në po them kujtimet e mia janë pozitive kur është fjala për shoqërimin me ata fqinjët. E këndej në [rrugën] Trajko Dimitrijeviq, pas Odës Ekonomike, apo Hajdar Dushi siç është quajtur dikur, aty njejtë, vetëm se aty kemi pasur më pak fqinjë, aty ka qenë një ndërtesë. Katër banesa, një kat, një banesë. Dhe me ata fqinjë kemi qenë mjaft të afërt dhe jemi respektuar, maksimalisht. Por në atë rrugë kanë jetuar kumbarët e mi dhe shumë prej të njofshmëve dhe miqve, kështu që vizitoheshim, shkonim njëri tek tjetri dhe kështu.

Anita Susuri: Në vitet e '80-ta, domethënë të '80-tave kanë qenë demonstratat, si ka ndikuar te ju, si ka qenë për juve ato vitet?

Gordana Gjoriq: Po t'ju them diçka, kjo ka qenë, kjo ka qenë shumë e fuqishme, fillimisht... Askush prej neve nuk ka mundur të kuptoj se çfarë po ndodh. Tani po flas në emër të miqve më të cilët jemi shoqëruar, sepse ju kam thënë që barabartë kemi qenë të përfaqësuar shqiptarët, serbët, turqit, madje edhe sllovenët, dhe muslimanët për shembull. Gjithashtu miku jonë më i mirë ka qenë musliman, të mos them përkrah këtyre shqiptarëve. Dhe njejtë edhe në punë, këndej në "Transjug", nuk kemi mundur ta kuptojmë se çka po ndodh, pse po ndodh kjo, pse janë iniciuar ato demonstrata, por më duhet t'ju rrëfej një ngjarje.

Për shembull, demonstratat kanë qenë në vitin '81, në vitin '82 e kemi pasur ditën e “Transjugut” dhe atëherë ka ardhur zëvendësi i drejtorit gjeneral nga Rijeka, Vjencesllavi, rus dhe kur e kemi pasur atë festën në “Grand” dhe kemi qenë të ulur kështu të gjithë në tavolinë. Dhe në atë tavolinë ka qenë i ulur edhe drejtori im Munibca Hasi dhe unë, ish bashkëshorti im, pastaj Zhivojin Jako Jokanoviç, avokat i cili edhe sot është avokat në Prishtinë. I njohur për të gjithë, njeri i veçantë, i veçantë të mos them edhe profesionalisht dhe i respektuar prej të gjithëve edhe sot e kësaj dite, edhe prej shqiptarëve edhe prej serbëve, dhe të gjithëve, edhe disa njerëz, njëfarë Gjorgje Aksiq i cili është poashtu miku ynë familjar. Dhe më pyet mua zëvendësi i drejtorit gjeneral, Vjencesllavi thotë, “Gordana, çfarë ka ndodhur kështu? Si është gjendja këtu pas demonstratave?” Dhe unë i them, e më thotë, “Çka mendon ti rreth kësaj?” Unë kam qenë e re atëherë, i thash, “Me të vërtetë nuk mund ta kuptojmë se çka ka ndodhur”, dua të them askush prej neve nuk mund ta kuptoj, as shqiptarët nuk kanë mundur ta kuptojnë, këta që punonin, që ishin me mua, as ne. Tha, “Çfarë ka ndodhur aty?” Dhe mendoj, kemi jetuar bukur, i kemi pasur pagat e mira, kemi pasur mirëkuptim me njëri tjetrin, me të vërtetë.

Madje edhe kushdo që ka ardhur në Prishtinë atëherë nga çfarëdo vendi të Jugosllavisë, kanë qenë xheloz ndaj mënyrës tonë të jetesës. Këtë mund t’ua konfirmojnë 90 përqind banorë të gjeneratës së vjetër të cilët në atë kohë kanë jetuar në Prishtinë. Dhe të cilët kanë qenë njerëz normal, për të cilët marrja me politikë nuk ka qenë e rëndësishme apo ku ta di unë, të krijojnë ndonjë situatë negative, por i rëndësishëm ka qenë njeriu, ai shoqërimi ynë. Dhe thash, “Nuk e di me të vërtetë çfarë ka ndodhur, nuk mund ta besoj se çka, çka, çka, çka po na ndodh”. Ai thotë, “Kjo nuk ka kurrfarë lidhje” tha, “me shqiptarët. As me atë çfarë ata kërkojnë. Thjesht,” kështu, me këto fjalë, unë kam edhe dëshmitarë që mund ta konfirmojnë, kjo ka qenë ‘82-tën, tha, “Thjesht fuqitë botërore, në mes të cilave Amerika, ka pasur dëshirë që Jugosllavia të shkatërrohet për shkak të interesave të tyre. Dhe ka qenë vetëm një kockë e hedhur. Të shohim”, tha, “si do të jetë reagimi. Do ta shihni për një vit-dy apo pas ndonjë viti do të filloj”, tha, “sulmi ndaj armatës së Sllovenisë”.

Më besoni, ju betohem, unë jam shqetësuar aq shumë kur i kam dëgjuar ato fjalë. Po mendoj, për të gjithë ne, të shkatërrohet Jugosllavia. Sepse Jugosllavia ka qenë nocion i vendit të bukur, jetesës së bukur. Ne kemi qenë të vlerësuar nga ana e të gjitha vendeve në botë, pasaporta jonë ka qenë e vlefshme, kemi mundur të shkojmë ku kemi dashur dhe kur shkonim diku dhe kur na pyesnin, “Jugosllovenë”. “Aha, ju!” Ne kemi qenë me të vërtetë të respektuar si një kombësi po them, jugosllovene. E në botë një prej më të mirëve. Nuk kemi mundur të besojmë që mund të na ndodh ajo çfarë na tregonte ai, që do të fillojnë sulmet në armatën e Sllovenisë, pastaj kaosi, pastaj luftërat ajo-kjo dhe që me të vërtetë do t’i përjetonim të gjitha këto që i kemi përjetuar.

E dini çfarë më ka thënë atëherë Zhivojin Jokanoviç, ky drejtori tjetër ka shkuar dhe kur ka përfunduar festa, tha, “Goco, ky drejtor nuk është mirë”. Ashtu a din, tek ne thonë, kinse nuk është, nuk është i shëndetshëm, nuk është normal, çfarë po flet. Fatkeqësisht, të gjitha ato që i ka folur ai, ne i kemi përjetuar më vonë, në vitet e mëvonshme dhe kesi, (kollitet) unë kurrsesi nuk mund ta fshij dhe më vjen keq për të gjithë ata njerëzit që kanë pësuar, të cilët i kanë humbur më të dashurit e tyre. Dhe normalisht, nuk mund ta tejkaloj [dhimbjen] për atë jetën që e kemi pasur dikur dhe kurrë më nuk do ta kemi, dhe askush nuk do ta ketë një jetë të tillë siç e kemi pasur ne në Prishtinë.

Anita Susuri: Gjatë luftës, domethënë ajo ka qenë një goditje edhe për serbët edhe për shqiptarët që kanë jetuar këtu, si ka qenë për juve?

Gordana Gjoriq: Ka qenë, po ju them diçka, shumë e vështirë. Po mendoj, fillimisht, fillimisht nuk kemi mundur të kuptojmë që kjo mund të na ndodh neve edhe pse kemi pasur përvojë fatkeqësisht (kollitet) vinin nga Kroacia, nga Bosnja, a e dini. Së pari atje ka filluar.

[Rrëfimi vazhdon në pjesën e dytë]

Pjesa e Dytë

Gordana Gjoriq: E vetmja gjë që kemi mundur ka qenë të shikojmë sa mund t’ju ndihmojmë. Atëherë kur kanë filluar bombardimet, atëherë fqinjët e mi kanë qenë në rrezik, shqiptarët, ata kanë filluar, ata shpërnguleshin. Unë të vetmën gjë që e kam bërë ka qenë t’ju trokas fqinjëve të mi në hyrjen time, e këtë mund ta konfirmojnë...

Anita Susuri: Ju atëherë keni qenë në Prishtinë?

Gordana Gjoriq: Po, në Prishtinë, për t’i pyetur çka ju nevojitet që t’ua sjell. A duhet diçka të blej, a duhet diçka kështu të bëj? Po ashtu, jemi munduar kush, kush është nisur, kush na ka ftuar t’i dërgojmë që të shkojnë të sigurtë deri te stacioni hekurudhor, deri te stacioni i autobusëve, apo deri te kufiri, disa i kemi vozitur deri te kufiri. Po mendoj, kjo është kështu, nuk është dashur të ma bëni këtë pyetje sepse nuk mund t’i ndal emocionet (qan) sepse ja edhe me zotëri Zhika Jovanoviq të cilin e çmoj shumë, kesi (qan) ai më thërriste, “Hajde, Goco, duhet t’i vozisim disa miq tonë.” Pastaj shkonim në disa rrugë me veturë atje (kollitet) sa kemi mundur t’i vendosim familjet, disa anëtarë të familjes. Pastaj vozit këndeje, vozit në, pastaj e përjeton takimin me dikë, a e din, me këta, a është policia, apo... ato grupet që janë shfaqur në situata të tilla. Pastaj është dashur ta rrezikosh edhe veten në mënyrë që t’i mbrosh ata njerëzit që i ke marrur përsipër t’ju ndihmosh, t’i dërgosh atje deri te vendi i caktuar. Por po them, të gjitha që i kam bërë, edhe sot do t’i bëja, sepse kam konsideruar që të gjithë duhet t’i ndihmojmë njëri-tjetrit.

Por fatkeqësisht, kur kanë përfunduar bombardimet dhe kur organizatat ndërkombëtare dhe KFOR-i kanë hyrë këtu dhe kur banorët e Prishtinës kanë filluar të kthehen apo të tjerët që, po them, të shumtë kanë ardhur dhe e kanë uzurpuar po them vet Prishtinën, dhe po them, shtëpitë tona, banesat, kompanitë apo atë-këtë, nuk kam mundur, nuk e kam përjetuar të njejtën mbrojtje në atë masë që unë e kam ofruar mbrojtjen. E, tani, justifikimi ka qenë, t’ju them diçka, justifikimi ka qenë kinse nuk kanë guxuar. Po de, nuk kanë guxuar por edhe unë i kam përjetuar kërcënimet nga ana e grupeve të ndryshme, por unë shkoja. Pa marrë parasysh kërcënimeve, nuk kam lejuar që dikush të më frikësoj aq sa të jem në situatë që të mos i ndihmoj fqinjit tim, mikut tim, të jem në rend të parë kur njeriut i nevojitesh, gjë që është shumë e rëndësishme.

Kam qenë mjaft e zhgënjyer atëherë, prej, prej shumë njerëzve, të cilët nuk kanë, por prapë, ata miqtë e vjetër kush ka pasur mundësi, e janë disa, unë do të jem falënderuese sa jam gjallë sepse kanë qenë disa situata të rënda dhe ata njerëzit prapë janë hedhur në ndihmë. Dhe, të them, falë gjithë asaj, prapë nuk e kam humbur kurrë besimin te njerëzit dhe po them nuk e kam humbur atë dashurinë ndaj njerëzve. Dhe për mua vlera më e madhe është njeriu dhe çfarë ai ka brenda vetes. Ja edhe kjo, dhe ta përfundoj këtë tregim - ka ndodhur, mos të përsëritet më kurrë. Dhe duhet të gjithë të mundohemi, me të vërtetë, dhe ja, unë ju këshilloj juve të rinjve që sa herë ju jepet mundësia ta shpërndani dashurinë mes njerëzve dhe vlera të mbetet vlerë, çfarë të mira ka ai njeri dhe dituri dhe mjeshtri, e jo sa para ka, a ka ndonjë vilë dhe veturë të mirë sepse këto të gjitha janë shumë, shumë të parëndësishme kur është fjala për kualitetin e jetës në pyetje.

Anita Susuri: Deshta t'ju pyes diçka më të bukur. Si jeni njoftuar me bashkëshortin e tanishëm?

Gordana Gjorij: (qesh) Po kjo është prapë një, një tregim. T'ju them diçka, në jetë ju ndodhin gjëra që nuk mund t'i planifikoni as t'i përcaktoni. Thjesht, unë them kjo është caktuar që nga lindja e njeriut. Dhe sado që mundohesh t'i anashkalosh shumë gjëra në jetë, thjesht nuk mund t'i anashkaloni dhe ato ndodhin. E unë nuk e përmenda për vete që jam divorcuar '98-tën. Thjesht nuk kemi mundur të merremi vesh, ka pasur aty shumë, shumë probleme. Dhe unë atë e njihja nga qyteti. Dhe kemi bashkëpunuar sepse si kompani, ashtu kishim reklama në atëherë RTS, RT Prishtinës. Pastaj i kemi pasur miqtë e përbashkët ashtu, pastaj mbledheshim te disa, te ashtu-kështu. E ka ndodhur që atij gruaja, gruaja e tij është sëmurë dhe fatkeqësisht ka vdekur nga kanceri.

Pastaj fëmijët tonë shoqëroheshin, shkonin në të njejtën shkollë dhe kështu. Dhe, tani ne si miq jemi munduar t'i ndihmojmë, që ai ta tejkaloj atë dhimbjen, atë situatën, ka mbetur i vetëm me fëmijët, pastaj, a e di, gjithçka në jetë ndryshon kur e humb dikë, një anëtar të familjes, sidomos bashkëshortin. Dhe ne me të vërtetë kemi qenë vetëm miq. Unë jam munduar t'i ndihmoj sa kam mundur atëherë, ashtu përmes tregimit. Ai mua me ditë të tëra më ka treguar tregimin e jetës së tij, marrëdhënjen me gruan, si është takuar, pastaj për disa situata të bukura dhe situata të këqija që i ka pasur në jetë. Kështu që, e ka pasur më të lehtë me siguri ta ketë dikë për të biseduar, për t'i evokuar kujtimet dhe kështu ta tejkaloj atë dhimbjen e madhe që i ka ndodhur dhe atë tragjedinë e madhe që i ka ndodhur.

Dhe përmes atij shoqërimi ne thjesht, ka kaluar kohë, normalisht, muaj, thjesht a e dini kur thonë "jeni gjetur", a din? Dhe, dhe, dhe, dhe më kuptoni që së pari, shumë jemi të ngjashëm, sepse ai është njeriu jashtëzakonisht i mirë dhe unë garantoj që për të, cilindo shqiptar ta pyesni nga Prishtina, e të shumtë e dinë, të shumtë kanë bashkëpunuar me të. Unë ja, për sa jemi bashkë, 21 vite, unë nuk kam dëgjuar tregim negativ për të. Domethënë, askush nuk ma ka thënë një fjalë të keqe, por të kundërtën të gjithë thonë, "A, Zlatko? Ai është mbret" a din, po mendoj, e kjo është bazike që unë të jem me dikë. Kjo është bazike edhe nëse shoqërohem me dikë, të kuptohemi (buzëqesh). Domethënë, duhet të jetë me të vërtetë i mirë.

Kështu që ja ne jemi bashkë, ne nuk jemi kurorëzuar, ne nuk jemi në martesë, ashtu me letra, që do të thosha unë, por për këto 21 vite me të vërtetë jam falënderuese ndaj Zotit që e ka dërguar në udhën

time ta takoj sepse atë e kam mik të madh, e kam vëlla, e kam përkrahje, i kam të gjitha që janë të nevojshme për një njeri. Së dyti, ai i ka dy djem, i ka katër nipa. Me familjen e gruas së tij të ndjerë gjithashtu jam shumë e afërt. Domethënë, janë njerëz të mrekullueshëm, ata përndryshe me prejardhje janë nga Prizreni.

Kjo domethënë kur ka dashuri, atëherë nuk duhet të shqetësoheni, tani na ka mbetur vetëm, sepse i kemi bashkë tetë nipër (qesh) dhe i nënti është në rrugë. Dhe atëherë kur, ata të gjithë janë në Beograd, kur shkojmë atje, e mundohemi të shkojmë më shpesh, që të mos kaloj periudhë e gjatë, sepse edhe na merr malli, t'i shohim fëmijët dhe të qëndrojmë me nipa, por mirë që po vijnë edhe ata tek ne këtu, kur janë pushimet, festat dhe kështu. Dhe atëherë mblidhemi të gjithë së bashku.

Ja tani për shembull, ribashkimi i fundit ishte, Zlatko kur ka dalur në pension, dhe e ka fituar çmimin nga Lidhjes së Artistëve të Estradës Serbe për vepër jetësore. Dhe kjo ishte arsyeja që të gjithë të festojmë, pastaj jemi mbledhur të gjithë në një restaurant (qesh) edhe fëmijët e tij edhe të mitë, nipat dhe kështu, gjeneratat më të reja, dhe e kemi kaluar një pasdite të mrekullueshme të gjithë së bashku. Përndryshe ata shoqërohen, i ndihmojnë njëri-tjetrit kështu, pasi që të gjithë janë njerëz familjarë, e unë dhe Zlatko jemi aty të ndihmojmë nëse duhet ta ruajmë ndonjë fëmijë, të shkojmë atje, të ndihmojmë, apo t'i sjellim këtu të qëndrojnë me ne apo diçka tjetër nëse nevojitet dhe kështu.

Anita Susuri: Domethënë, 21 vite jeni së bashku.

Gordana Gjoriq: Po, 21 vite jemi bashkë, dhe po them, këtu më ka shpërblyer Zoti (qesh) pa marr parasysh situatën që e kemi pasur prej '99-tës, dhe ka pasur me të vërtetë të rënda, momente shumë të rënda. Ka pasur madje edhe momente ku për pak e kam humbur jetën sepse nuk, nuk ju kam thënë që kam qenë në autobusin i cili u ngrit në ajër në Livadicë. Dhe atëherë kam qenë e lënduar, por...

Anita Susuri: '90, '99-tën ka qenë kjo?

Gordana Gjoriq: Jo, jo, 2001. 2001, 16 shkurt. Dhe fatmirësisht unë vetëm jam lënduar, e fatkeqësisht e dini që atëherë kanë vdekur dymbëdhjetë, bashkëqytetarë tonë... por ja po them, të gjitha këto që i kemi përjetuar, shumë më lehtë ka qenë kur e ke dikë, dikë që të do, kujt ja ndjen për ty dhe kush mund të ndihmoj, të jetë përkrahës në çdo aspekt. Domethënë, a është në pyetja kjo jeta private apo zyrtare, sepse unë pastaj kam vazhduar të punoj edhe këtu, sepse kam punuar privatisht, divorci, kompania e uzurpuar, gjithçka e vjedhur, kemi mbetur, po mendoj, unë kam mbetur pa asgjë. Nuk kam pasur bukvalisht me çka t'i mbaj fëmijët.

Pastaj kam filluar me një pompë benzine të cilën... ku i kam punësuar pesë punëtorë dhe ne deri në vitin 2010, unë jam marrur me punë private dhe kështu e kam mbajtur familjen dhe veten, dhe normalisht të gjithë punëtorët që kanë qenë aty kanë pasur të ardhura.

Anita Susuri: Domethënë, të '90-tave e keni iniciuar kompaninë tuaj private?

Gordana Gjoriq: Po.

Anita Susuri: Ashtu?

Gordana Gjoriq: Po.

Anita Susuri: Si ju ka funksionuar puna atëherë?

Gordana Gjoriq: T’ju them diçka, atë dije që e kam marrur atëherë në “Transjug” dhe normalisht me të gjitha ato që m’i ka mësuar, drejtori i atëhershëm, Munibca Hasi. Por edhe miqtë që i kam pasur në atë kohë, me të vërtetë, kam mundur t’i bëj, ashtu të them, hapat më të shpejtë që ajo kompani të filloj ashtu më shpejtë në një zhvillim dhe zgjerim, të them ashtu. Atëherë, e gjithë situata ka qenë, në ekonomi shumë e keqe, dhe pastaj kur shfaqej një kompani që ka kualitet, e unë veçanërisht jam munduar që kompania ime të ofroj kualitet, a është fjala për mall apo për shërbimet që i kemi pasur sepse ju... me shumë grupe, veprim, e kemi zgjeruar, e tillë ka qenë situata. Pastaj, në rend të parë ka qenë shumë e rëndësishme kjo që thash, besimi ndër njerëz.

Dhe, dhe po them, në fillim ka qenë që kemi filluar të punojmë ne, fillimisht vetëm unë, pastaj i kemi marrur edhe dy, tre, e kam filluar të punoj prej banesës, po mendoj, aktivitetet e shërbimit. E pastaj si jam zgjeruar, thjesht ka qenë e nevojshme që ne të marrim hapësirë dhe hapësira e parë që e kemi blerë atëherë, ka qenë ndërtesa e “Auto Prishtinës” atëherë, ku është hotel “Viktoria” tani. Dhe gjithë atë katin e fundit, aty ka qenë hapësira jonë, e poshtë ka qenë depoja e madhe, jemi marrur me shitjen e autopjesëve, paisjet HTZ, kemi bashkëpunuar shumë atëherë me fabrikën e amortizerëve, ne kemi qenë blerësi numër një për materialin ndërtues.

Pastaj kemi filluar edhe me informatikë. Informatika është zhvilluar tek ne, të them ashtu. Ne kemi qenë ndër të parët që i kemi njohur kërkesat e tregut atëherë, e i kemi pasur njerëzit e rinj që kanë qenë të shkelqëyer, IT ekspertë. Normalisht, i dërgonim nëpër trajnime të caktuara dhe seminare, që po them, të edukohen apo kualifikohen për ca gjëra. E pastaj, ka qenë embargo që Jugosllavia e ka pasur atëherë nga ana e këtyre vendeve të tjera dhe atëherë nuk ke mundur të gjes, as *hardware*, kur është fjala, domethënë pjesë të kompjuterit, e nuk ke mundur të gjes as *softver*. E ne kemi qenë ata, kompania jonë, një jesë, ajo pjesa e informatikës, ka bërë *softver* me porosi. Të gjitha ato që kanë qenë të nevojshme.

Atëherë kemi bashkëpunuar me shumë fabrika, institucione, domethënë për të gjithë ato që ka qenë të nevojshme të bëhet inxhinieri kompjuterike, ta quaj ashtu. Ne kemi qenë totalisht të përgaditur që si kompani të i ofrojmë ato shërbime dhe normalisht trajnime të ndryshme dhe të gjitha këto. Kështu që në kompaninë tonë kanë punuar 75 punëtorë, të të gjitha kombësive. Madje mund të them, që në një periudhë ka pasur më së paku popullsi serbe. Domethënë a kanë qenë shqiptarë, kanë qenë romë, kanë qenë turq dhe muslimanë, dhe serbë normalisht.

Dhe kryesisht merrja punëtorë të rinj, dhe unë kam ndarë shumë, shumë kohë të flas me ata punëtorët. Dhe nuk i kam punësuar në mënyrë strikte për atë profesion që kërkohej, por kam dashur që dikush që është përballë meje të jetë i gatshëm ta, ta, ta arrij cakun e suksesit në atë pjesë të punës,

pastaj unë si kompani t'ia jap mundësinë ta gjej veten, ku mundet në mënyrë maksimale më së miri t'a ofroj diturinë e tij, ekspertizën apo ta gjej veten aty. Sepse kompania ka qenë e tillë që ka pasur më shumë sektorë, më shumë mundësi prandaj në shumicën e rasteve, përveç asaj që në mënyrë strikte ka qenë e nevojshme, po mendoj për disa, për ndonjë vend të punës, por kështu i kam ofruar secilit një muaj kohë kush vinte të punonte tek ne ta njoftoj kompaninë dhe t'i ndërroj ashtu të them sektorët.

Dhe atëherë të merr vendim vet ku mundet veten maksimalisht ta... dhe normalisht të fitoj dituri maksimale profesionale, trajnimi dhe gjithçka që duhet, dhe në fund të ketë të ardhura, të ardhura personale, të jenë deri në atë masë sa ai vetë ka kontribuar. Kështu që, me të vërtetë e kam pasur bashkëpunimin e mrekullueshëm, me të gjithë bashkëpunëtorët e mi. Dhe, dhe sepse edhe si kompani, jam munduar që, të merrem edhe me problemet e tyre private dhe si epror direkt i tyre apo si kolege, të them ashtu, t'ju ndihmoj edhe privatisht. Dhe çka mendoj që është shumë e rëndësishme, nëse dëshironi që ta fitoni maksimumin prej punëtorit. Ai duhet të jetë i sigurtë edhe me juve si epror, por edhe me kompaninë për të cilën punon.

Anita Susuri: Ju domethënë me atë, të them biznesin, jeni marrur deri në kohën e luftës?

Gordana Gjorij: Deri në vitin '98 kur, kur edhe jam divorcuar. Duke pasur parasysh që bashkëshorti im ka qenë bashkëpronar. Dhe pastaj, pas divorcit unë e kam marrur përsipër sepse e kemi bërë marrëveshjen që kompaninë ta vendos në këmbë, që ata punëtorët t'i kenë pagat e mira, por fatkeqësisht, pas kësaj ka ndodhur gjithçka ajo që ka ndodhur, kështu që kjo ka dështuar (qesh) kësi, sepse kompania është vjedhur, uzurpuar. Atëherë në kohën e bombardimeve atëherë edhe nuk është mundur të punohet, e pastaj pas kësaj gjithçka ka dështuar, të them ashtu.

E atëherë unë, lëndën e parë e kanë punuar, nuk mund të përfundonim ndarjen e trashëgimisë martesore, kështu që unë (kollitet), e nuk kam pasur kurrfarë të ardhura në atë kohë, dhe pastaj më ka mbetur vetëm këtë pompën [e benzinës] e cila ka qenë e karakterit intern në Llapllasellë, sepse ka shërbyer për veturat tona, ta vë në funksion dhe bashkë, normalisht atëherë nuk kam pasur para, por një i ri këtu nga Llapllasella, ai ka pasur mjete pastaj bashkë, ai ka investuar, dhe bashkë kemi punuar. Pastaj ai mua ma ka lënë që unë ta menaxhoj vet. Unë normalisht i'a kam paguar investimet e tij dhe deri në 2010-tën, kam qenë pompash³ (qesh).

Anita Susuri: Ju domethënë, pas luftës keni ardhur këtu dhe si ndjeheni tani këtu në Llapllasellë?

Gordana Gjorij: Po, bukur. Unë me të vërtetë jam shumë e lumtur këtu. Dhe sidoqoftë... kur dikush më pyet, "Ej, si mundesh, megjithatë, situata politike nuk është stabile..." e tmerrshme, qe 20 vite, sepse po i dëgjoj edhe tregimet e miqve të mi. Kurrsesi të rregullohet situata, kurrsesi të krijohet sistem i tillë që të gjithë që jetojmë këtu të kemi mundësi ta planifikojmë jetën tonë. Ne nuk mund të planifikojmë asgjë këtu. Nuk mund ta planifikoni as jetën private, e të mos flas për punën. Pikërisht për shkak të sistemit që nuk funksionin. Qeveria e vërtetë nuk ekziston, por janë ato grupet e interesit të

³ Në zhargon - person që posedon pompa të benzinës

cilat marrin vendim për gjithçka, politike apo të tjera. Dhe normalisht këto (qesh) fuqitë botërore të cilat na diktojnë si, çka dhe gjithçka varet prej interesit të tyre, kështu edhe jeta jonë varet.

Por, pa marrë parasysh gjithë këtë, unë, unë jam prapë te njerëzit e mi, sepse unë këta njerëz i njoh që nga fëmijëria. Shumtë prej tyre njejtë si unë kanë ardhur këtu nga Prishtina, apo nga ndonjë vend, Mitrovica apo kështu. Pastaj, takohemi dhe... e dyta unë kam fqinjë të mrekullueshëm, sepse kur në fqinjësi keni njerëz të mirë, atëherë është me të vërtetë kënaqësi të jetohet në atë ambient. Kësi, mua më njohin që nga fëmijëria këtu dhe këtu nuk kam nevoj të tregohem se kush jam, çka jam. Ata e dinë që unë jam kështu e kështu dhe atëherë është shumë më lehtë të jetosh në një rreth ku të njohin.

Dhe, dhe së dyti, që njerëzit këtu kanë mbetur të lidhur me njëri-tjetrin. E unë nuk do të mund të jetoja diku ku, ku njerëzit nuk duhen, ku i bëjnë të këqija njëri-tjetrit, ku, ku ta di unë, janë të ngujuar në bashkësinë e tyre të vogël {i ndërlihd gishtat dhe i bashkon duart} apo në shtëpi dhe nuk dëshirojnë të shoqërohen. Ne këtu shoqërohemi. Ne këtu, po mendoj, mua kurrë nuk më ka ndodhur që unë çkado qoftë të bëj në oborr dhe të mos vjen dikush nga fqinjësia dhe të thotë, “Po të ndihmoj” apo ata diçka të bëjnë e ne të mos shkojmë. Apo, ku ta di unë, çfarëdo ngjarje që bëhet në Graçanicë ne jemi aty bashkë, ta përcjellim atë ngjarje. A është ndonjë ngjarje kulturore, apo është ndonjë, ku ta di, ngjarje fetare, a është ndonjë ngjarje familjare apo kështu.

Dhe atëherë e dini, kur jetoni në, në kushte të tilla, unë jam mësuar me diçka të tillë, mua nuk më nevojitet diçka tjetër. Unë nuk jam njeri që e do luksin, të shkoj diku, të vizitoj, ku ta di unë, disa, disa vende që janë në ku ta di unë, në trend, të sheh dikush aty, ku ta di. Por për mua është e rëndësishme me kë do të rri dhe do të bisedoj, a shpërndan energji pozitive ai person. E, ajo energji më nevojitet gjithmonë, sikurse edhe unë normalisht po mundohem që kudo që shkoj ta shpërndaj atë energjinë pozitive e cila i nevojitet gjithkujt dhe nëse mundem, të më kujtojnë njerëzit përmes tregimeve të bukura dhe ndoshta me një ngjarje të bukur apo ndihmë që e kam dhënë, e jo për atë se a kam ndonjë vilë të madhe, apo kam, ku ta di unë, apo kam qenë në ndonjë mbledhim atje ku kanë qenë më të njohurit, “më të njohurit” njerëz në thonjëza {bën thonjëzat me duar}. Dhe kështu, kjo është ajo, unë...

Anita Susuri: Ju e keni themeluar edhe shoqatën “Avenija”. Si ka ardhur deri te kjo?

Gordana Gjorij: Po t’ju them diçka, ‘99-tën, duke pasur parasysh që të gjithë ne këtu kemi mbetur pa punë, të përzënë prej qyteteve tona, kompanive tona, edhe prej shoqërisë dhe sektorit privat, gjithçka është shkatërruar edhe kjo e ajo. E unë si pronare dhe drejtoresh e kompanisë kam qenë shumë aktive në ato shoqatat ekonomike, a është ajo Oda Ekonomike e Kosovës dhe Metohisë atëherë apo Oda Ekonomike e Serbisë, apo Jugosllavisë në atë kohë, apo shoqata e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, apo Unioni i Punëdhënësve dhe kështu. Sepse ne qysh në ‘86-tën e kemi formuar Unionin e Punëdhënësve të Serbisë, atëherë, ku të gjithë, po mendoj, ata punëdhënësit që kanë konsideruar se duhet të bashkohen sepse unë kam konsideruar që duhet të bashkohem, sepse gjithmonë në shoqatate tilla, mbledhimet, t’i mund t’i njoftosh partnerët e tjerë të biznesit dhe ta fillosh bashkëpunimin, që mund ta prezantosh më mirë kompaninë tënde dhe normalisht të kesh biznes më të mirë.

Kështu që, në vitin '99 pastaj, ne së bashku me Odën atëherë cila ka qenë, e zhvendosur në Mitrovicë dhe në Pri... Oda e Serbisë, e kemi formuar shoqatën e sipërmarrësve, nëpër ato hapësirat e vogla me qëllim që njerëzit të mbliidhen aty dhe në një vend të marrin informata dhe të shohin çfarë mund të punojnë, sepse pa punë nuk mund të mbijetoni, e dini. Por edhe fakt ka qenë që në atë kohë gruaja, (qesh) gruaja jonë, kurrë nuk ka mundur të vij në shprehje, sepse e dini ne jemi, ne jetojmë në një rreth patriarkal. Pa marr parasysh kohën dhe pa marr parasysh në, po them, profesionin apo, po them këtë, presionin që e kanë nga ana e institucioneve përkatëse, shoqata, ajo-kjo, që gratë të jenë të barabarta, fatkeqësisht, ende është ajo problem. E në të '90-tat, përkatësisht në vitin 2000 kur ne edhe kemi filluar më intenzivisht të punojmë si shoqatë, ka qenë shumë e vështirë që gruaja të vie në shprehje.

Po ashtu, është fakt që gruaja në situata më të rënda është më e guximshme, sepse motivi i saj është ndihma për familjen, fëmijët, ruajtja e familjes dhe mbijetesja e familjes. Dhe ajo do të investojë të gjitha aftësitë e saj, tërë forcën, guximin, për të ruajtur familjen, për të ndihmuar familjen. Dhe kjo ishte ajo që treguan atëherë gratë tona. Dhe atëherë unë, normalisht, me marrëveshje të Odës Ekonomike të Serbisë, sepse si shoqatë kemi qenë të regjistruar në regjistrin e Odës Ekonomike të Serbisë në atë kohë dhe këtu në shtëpinë time, duke pasur parasysh që kam hapësirë, nuk na është nevojitur paraja. Aty edhe e kemi formuar zyren dhe aty ju kemi ofruar mundësi grave të vijnë dhe bashkë me mua që kam përvoj të madhe me ndërmarrësi po them, edhe në ekonomi, të shohim çfarë mund të bëjmë në bazë të asaj që i posedojnë - a kanë dituri dhe përvoj apo ka diçka që posedon në kuadër të familjes që ajo të filloj ndonjë punë dhe të mbijetojnë. Po mendoj, fillimisht të mbijetojnë ato familjet, dhe normalisht t'i punësojnë anëtarët e tjerë të familjes.

Ky ka qenë motivi. Domethënë, zhvillimi ekonomik i gruas. Atëherë kemi pasur ndihmë të madhe nga USAID-i, përmes projekteve të tyre, KBS⁴, CBS⁵. Atëherë, kemi pasur ndihmë të madhe, normalisht, edhe nga Oda Ekonomike e Serbisë në atë kohë, kemi pasur ndihmë edhe nga Agjencia për Zhvillim Rajonal të Serbisë në të cilën kanë qenë njerëz të caktuar të cilët kanë dashur të ndihmojnë. Po ju them, sepse institucioni si institucion, agjencia si agjenci, nuk vlej nëse nuk janë njerëzit të cilët sinqerisht dëshirojnë përmes disa aktiviteteve, projekteve të i ndihmojnë komuniteteve apo një grupi të caktuar të njerëzve. Në atë kohë ka pasur njerëz të cilët sinqerisht kanë dashur të punojnë. Sepse ai sistem i vlerave nuk është përmbysur në tërësi {lëviz duart në rreth} po them, nuk është prishur. Për atë kohë po flas.

Prandaj kemi mundur atëherë, të kemi ndihmë në, po them në këshilla, edukim, por ka pasur edhe fonde që jo shoqatës, por unë kam insistuar që anëtareve direkt t'ju ndihmohet. Për shembull, nëse shpërndajnë diçka, kërkesa për serrë, atëherë direkt ajo anëtare silllet këtu. Ajo e bën marrëveshjen me atë, po them, fondacion, cilado qoftë. A ka qenë KFOR-i, dhe ata kanë pasur mjete të tilla apo ndonjë organizaë tjetër, edhe ata kanë dhënë. E unë kam qenë aty t'i ndihmoj ato anëtarët, të cilat... po them për ta projektuar atë biznesin e vogël. Dhe normalisht edhe për t'i ndërlidhur, subjektet e ndryshme ekonomike ku ata kanë mundur t'i blejnë paisjet apo t'i plasojnë pastaj produktet e tyre që ka qenë shumë e rëndësishme.

⁴ Kosovo Business Support (Mbështetje Bizneseve të Kosovës).

⁵ Creative Business Solution (Zgjidhjet Kreative Biznesore).

Dhe kemi pasur mjaft sukses atëherë me të vërtetë. Por pas kësaj, ja edhe sot e kësaj dite kanë ndryshuar mjaft gjëra. Ja, duhet të them edhe publikisht, e me siguri edhe ju keni pasur përvoj që tani ju nuk mund të konkuronni diku nëse nuk ju kërkojnë përqindje. Po mendoj, nëse nuk mund të ndani përqindje për njerëzit e caktuar. Është e tmerrshme. Për mua kjo është e tmerrshme. Unë tani thjesht nuk mund të funksionoj në atë mënyrë. Sepse nëse dëshirojmë t'i ndihmojmë njëri-tjetrit, atëherë unë do t'i investoj të gjitha që unë i di që ai projekt të ketë sukses edhe ky projekti juaji edhe ndonjë tjetër i cili do t'i ndihmoj komunitetit tonë t'i rishikojmë disa gjëra, dhe t'i dëgjojmë disa tregime të tjera.

Ndoshta, “Prit ta ndryshoj ndërgjegjen time. Nuk është gjithçka ashtu si kam, si ma ka prezantuar dikush, por edhe unë e kam atë hapësirën.” Apo për shembull të mundohemi së bashku që zhvillimi ekonomik të filloj këtu. Të fillojmë edhe me hapjen e vendeve të reja të punës, të rinjtë t'i mbajmë këtu, të qëndrojnë, t'i shtyejmë institucionet prej gjyqësorit e deri te të gjitha të tjerat, të sundoj ligji të jemi të gjithë të sigurtë këtu. Dhe të shikojmë e ta krijojmë mjedisin me të vërtetë ku do të vinin të, të, të punonin dhe jetonin e jo të ikim nga këtu.

Por, fatkeqësisht, sado që ne mundohemi, apo të them, unë apo ju, para organizatës tjetër joqeveritare apo një të tretë, thjesht, po them, na ka fituar ai grup i njerëzve për të cilët vlera është kryesisht paraja dhe që nuk zgjedh mënyra si të vij deri tek ajo para. Përmes korrupsionit, përmes krimit, përmes po them mobingut dhe eliminimit të të gjithë asaj që është kualitative dhe e mirë, profesionale në, në mjedisin tonë. Dhe kjo është diçka që më mposht si njeri apo edhe si profesioniste, dikush që, dikush që mundet ende shumë të kontribuoj, po them komunitetit tim, t'i, t'i ndihmoj, të ndjehen të sigurtë këtu të fitojnë deri... mjaft sa të jetojnë një jetë normale. E jo të, të mbijetojnë sikur që po ndodh me vite apo vetëm të shikojnë mundësinë si të ikin nga ky rreth, kudo. Por të gjithë që shkojnë, vetëm thonë, “Kudo qoftë, vetëm këtu më jo! Kudo vetëm këtu jo”.

Tani, si shoqëri, çfarë duhet të bëjmë për ta ndryshuar atë? Nuk ka asnjë mundësi që, po të themi, t'i prishim këto, këto grupe interesi që kanë qeverisur për vite me radhë këtu, dhe të themi, shkatërrojnë jetën tonë. Ja, sinqerisht. Sepse në bisedat tona me shumë njerëz, më lejoni t'ju them, njerëzve, kudo që janë në një situatë, në ndonjë situatë për të inicuar diçka pozitive, ata hasin në pengesa të këtij lloji, të cilat unë i them, dhe pastaj ju e shihni që gjithçka është kalbur. Këto organizata ndërkombëtare që kanë përqaftuar lehtësisht të gjitha ato rregulla këtu për këto grupe interesi, të cilët, të cilët nuk kujdesen për situatën këtu dhe që të gjithë kemi një jetë normale së bashku, të zhvillojmë ekonomikisht, ta forcojmë, të përmirësojmë cilësinë e jetës tonë, të krijojmë përsëri një situatë për një shoqëri, dhe të mos shikosh kush është dhe çfarë kombësie ka, por se çfarë personi është ai dhe a është mirë të flas me ty. Fatkeqësisht... nuk e di. Unë po them shpresa është e fundit, diçka që a din, e fundit që vdes, dhe ende, ende kam shpresë që diçka do të ndryshoj, por fatkeqësisht tashmë po zbehet ky, ashtu të them, besim.

Dhe më e keqja është për një njeri kur je i pafuqishëm të ndryshosh çkado. Po mendoj, sa më shumë të mundohesh i pafuqishëm je. ka këtu, nderi i përjashtimeve me të vërtetë, ka njerëz ekspertë, njerëz me cilësi që, ky, kanë të njëjtat mendime, kur flasim kështu, por ata bëhen të pafuqishëm. I paaftë për të ndryshuar ndonjë gjë sepse nuk ju pyesin, nuk jeni (kollitet) nuk merrni vendim ju, pakicë jeni, pakicë

shumë e madhe. Po flas tani për kualitetin e njerëzve, jo për kombësi, që çkado të ndryshojmë në atë pjesë pastaj na mbetet vetëm ajo, a e dini, lutjuni Zotit dhe thoni, “A do të ndodh diçka që...” {shikon lart dhe i hap duart} a din, që përnjëherë të ndryshoj kjo, të shkëlqej dielli këtu, me të vërtetë më në fund fillon të... në një drejtim tjetër, në drejtim më të mirë, të zhvillimit, a din për kualitetin e jetës dhe kualitetin e njerëzve. Fatkeqësisht, deri tani ka qenë kështu, dhe...

Por, prapë, gjatë jetës njeriu mësohet që, shumë gjëra, të mos e prekin, a din, emocionalisht po flas, sepse nuk do të mund të, unë nuk do të mund të jetoja, sepse nuk dua të jem në situatë që unë të jem ajo që gjithmonë ankohet, shpërndan energji negative, e cila gjithmonë frikësohet prej diçkaje. Përkundrazi, unë në jetë kam qenë gjithmonë pozitive dhe, dhe, dhe disi them, “Ajt se do të bëhet mirë” dhe edhe nëse vjen dikush them, “Po ashtu është, por ja këta jetojnë edhe më keq. Po hajde të...” a din, të mundohem nëse nuk kam mundur në këtë mënyrë dikujt t’i ndryshoj diçka, atëherë shkoj në [mënyrën] e tretë {lëviz duart në gjysmërreth}, të katërt.

Nuk e humbas, nuk e humbas vullnetin dhe besimin, që diçka mund të ndryshoj. E sa për mua personalisht dhe atë që mund të vendos vetë, unë me të vërtetë mundohem të shfrytëzoj sa më shumë këtë, dhe ta shfrytëzoj maksimumin çdo ditë dhe të ndryshoj diçka në atë drejtim. Dhe kështu më duket, mendoj dhe jam e sigurt {i qon duart lart} që kështu edhe (qesh) do të vdes në fund. Dhe dëshiroj, po them, që, që të shpërndaj prej familjes time deri te miqtë, t’i shpërndaj ato tregimet pozitive, pozitive, po them idetë, të cilat mund t’i afrojnë njerëzit, që mund të kontribuojnë për jetë më kualitative për njerëz dhe kështu.

Ja, këta individ që janë kështu në disa institucione... fatmirësisht, has në njerëz të tillë që sinqerisht dëshirojnë të të bashkëngjiten. Pastaj kështu së bashku të {sikur shtyen diçka para} bëjmë diçka. Nganjëherë nuk kemi sukses, por... do të kishte shumë më shumë nëse nuk do të ishte korupsioni, ato shantazhet, të them ashtu, ja, “Do ta kesh projektin, por...” a din. “Duhet të ndajmë për atë, për këtë...” Dhe modestia nuk ekziston te ata, por ata janë gjithnjë e më shumë të pa... të pa ngopur dhe ata po kërkojnë gjithnjë e më shumë, e unë nuk kam dashur kurrë {me duar tregon jo} të inkuadrohem në mënyrë të tillë, po them, të punës, sepse duhet t’i jepni shpjegim bashkëpunëtorit tuaj, fqinjit tuaj, kolegut tuaj, a din, ku janë paratë? Ku i keni harxhuar? E unë i kam 60 vjet, tani 61. Nëse kam jetuar në këtë mënyrë deri tani, të jetosh kryesisht prej punës tënde, që gjithçka që bën të jetë transparente, të jetë publike, të jetë e dobishme për të gjithë,

Prandaj po them, gjithmonë jam munduar që çfarëdo që kam bërë, e kam bërë për interesin e shoqërisë, për interesin e të punësuarve të mi, për interes, domethënë, për interes të përgjithshëm, ajo është e rëndësishme për mua. E kur interesi i përgjithshëm është i kënaqshëm, atëherë është edhe i joti (qesh) interesi personal i kënaqur. Këtë kursesi njerëzit nuk mund ta kuptojnë, a din, por ata shikojnë kryesisht interesin e vet duke mos menduar se si, për shkak të veprimeve të tilla, për shkak të veprimeve të tilla që ata dëshirojnë të pasurohen vetë personalisht, që ata personalisht, të përfitojnë dhe po them t’i mbushin xhepat e tyre, shkatërrojnë gjëra të mëdha, gjëra të mëdha rreth tyre, fatkeqësisht, qytetarët e ndjejnë këtë në cilësinë e jetës së tyre dhe nga ajo që ata nuk kanë mundësi ta ndryshojnë.

Anita Susuri: Mirë, zonja Gordana, nëse keni edhe diçka për fund të shtoni, nëse diçka keni harruar?

Gordana Gjoriq: Po ju them diçka, (qesh) për tregim. Mund të flasim me orë të tëra. Fillimisht, ju falemnderit juve që e keni nisur këtë projekt, që mundemi lirisht dhe të gjitha, jo të gjitha normalisht sepse më duhet kohë (qesh) për diçka të tillë, por të paktën themeloren, atë që më keni pyetur ju kam përgjigjur ashtu siç ndjehem personalisht. Dhe shpresoj që të gjitha këto tregimet e gjithë atyre njerëzve që tek ju, po ja që kanë folur para kamerës ndoshta do të ndikoj në shumë njerëz të tjerë që ndryshe ta shikojnë njëri-tjetrin dhe prapë ta dojnë njëri-tjetrin.

E kjo është më e rëndësishmja, sepse kur e doni njeriun të gjitha të tjerat janë të parëndësishme. Atëherë mundoheni që me të vërtetë atij njeriu t'i ndihmoni, dhe atë miqësi e kultivoni, që ai njeri të mbetet në rrethin tuaj. E normalisht që bashkë, po them, ndoshta edhe pak çka i ka mbetur mundësi kësaj gjenerate më të moshuar, që bashkë të krijojmë kushte më të mira, siç thash më herët, për të gjithë ata që jetojnë këtu, për fqinjët e mi apo bashkëqytetarët e mi apo, të rinjtë që (kollitet) të kenë besim në të ardhmen duke jetuar këtu, ja kjo është.

Anita Susuri: Ju falemnderit shumë!

Gordana Gjoriq: Ju falemnderit edhe juve.